

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BALLKAN FOODS" shpk**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 22.01.2021, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "BALLKAN FOODS" shpk.
- 2) Themeluesi i shoqërisë është Enis Haliti, atësia Shemsi, shtetas Kosovar, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me numër ID1676055, me numër personal 1170862712, i datëlindjes 22.09.1986, lindur në Podujevë, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Tregtimin e artikujve ushqimore: tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve të ndryshme ushqimore, duke përfshirë por pa u kufizuar; produkte të salcave, erëzave, produkte që qumështit, vezëve, vajrave, yndyrave të gatimit, drithërave, duhanit, farërave e ushqimit për kafshë, kafes, çajit, kakaos dhe produkte të tjera të ngjashme.
 - b) Tregtimin e artikujve të ndryshëm të konsumit: tregtimin me shumicë dhe pakicë të çdo produkti konsumi apo përdorimi shtëpiak, duke përfshirë por pa u kufizuar; produkte të pastrimit, kujdesit, produkte shtëpiake, të tekstileve, aktivitete të ambalazhimit, veshje, këpucë, dhe produkte të tjera të ngjashme.
 - c) Importimin dhe eksportimin e artikujve ushqimore, artikujve të tjerë të konsumit dhe pajisje të tjera në funksion të aktivitetit: importe mallra ushqimore, lëndë të para, produkte të gatshme dhe gjysmë të gatshme, artikuj të tjerë konsumi, import të pajisjeve të ndryshme, pajisje të magazinimit, ruajtjes, staxhionimit, dhe çdo mall apo shërbim i nevojshëm të ciklit të jetës së produktit.
 - d) Ofrimin e shërbimit të ruajtjes, shpërndarjes, magazinimit të artikujve të tregëtueshëm, përzierjen, përpunimin e nevojshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme.
- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga e "Elbasanit", Pallati Fratari, Shkalla 1, Kati 6, Apartamenti 27, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind e njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku, Enis Haliti.

Faqë 1 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
BALLKAN FOODS shpk



- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te përcaktuara ne ligj.
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblënë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblënë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.



Neni 9
Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotéruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Enis Haliti, atësia Shemsi, shtetas Kosovar, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me numër ID1676055, me numër personal 1170862712, i datëlindjes 22.09.1986, lindur në

Faqe 3 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
BALLKAN FOODS shpk



Podujevë, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponoje në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuar nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdësi;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë më përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- d) tē parandalojē dhe mënjanojē rastet e konfliktit, prezent apo tē mundshēm, tē interesave personalë me ata tē shoqërisë;
 - e) tē ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrateve tē tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet nē mënyrë tē arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim tē rasteve kur, nē bazë tē hetimit dhe vlerësimit tē informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer nē mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron nē kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 tē këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime tē parregullta. Administratori ka barrën e provës për tē vërtetuar kryerjen e detyrateve tē tyre nē mënyrë tē rregullt e sipas standardeve tē kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë nē mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë tē veçantë, por pa u kufizuar nē to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktura, nëse, nē kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria tē vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, nē bazë tē gjendjes financiare, duhej tē parashikojë që shoqëria nuk do tē kishte aftësi paguese për tē shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë tē drejtë tē ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë tē drejtë tē ndjekin nē rrugë ligjore shlyerjen e plotë tē dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund tē ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit tē detyrës.

**KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

**Neni 16
Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë nē Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**Neni 17
Ekspertet**

- 1) Eksperti ka për detyre qe tē kontrollojë tē gjithë dokumentacionin kontabël tē veprimtarisë ekonomiko tregtare tē shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë tē tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 2) Në përfundim tē kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit tē bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat është i detyruar qe t'ju paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e tē drejtës vendimore qe ka.

**KREU V
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18
Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund tē behet ne çdo kohe:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar nē themelimin e saj;
 - b) me vendim tē Asamblesë se Ortakeve;

Faqe 5 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi tē kufizuar
BALLKAN FOODS shpk

- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqeri ne likuidim e sipër ".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."


**Neni 20
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njoitura nga ligji.

**ORTAK I VETËM
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BALLKAN FOODS" shpk**



Enis Haliti
(Emër, Mbiemër, Nënskrimi)

ENIS HALITI